

GAZETA
SHQIPTARE

BW FLASH NEWS

SHPËRTHIMI NË OBJEKTIN NË NDËRTIM NË SHËNGJIN, POLICIA E LEZHËS ZBARDH NGJARJEN,
ARRESTOHET 21-VJEÇARI NGA KRUJA (EMRI)

Fillimi > -Kronikë

Aksion "blic" në Tiranë, gjenden armë, drogë dhe thika, dy persona në pranga

11 Shtator, 2019 15:24 | 0 shfletime





TIRANË

Dy persona janë vënë në pranga të policisë, ndërsa u sekuestruan një armë zjarri pistoletë, armë të ftohta si dhe një sasi lënde narkotike e llojit kanabis. Sipas Policisë, në pranga kanë përfunduar shtetasit E. D., 33 vjeç dhe E. B., 25 vjeç, të dy banues në Tiranë.



Gjatë kontrollit fizik shtetasit E. D., iu gjet një armë zjarri pistoletë me krehër me fishekë, ndërsa shtetasit E. B., iu gjet një armë e ftohtë thikë dhe një sasi lënde e dyshuar kanabis .Policia ndërkohë vijon hetimet për zbulimin e personave që dyshohet se bashkëpunojnë me dy të rinjtë, tashmë të arrestuar.

Njoftimi i policisë:

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Nr. 6 operacioni policor i koduar “Aleati 2” Në pranga dy shtetas. Sekuestrohet një armë zjarri pistoletë, një armë e ftohtë thikë dhe një sasi lënde e dyshuar kanabis. Komisariati i Policisë Nr. 6 në sajë të



ndimë më mirë me sukses operacionin policor të koduar "Aleati 2", me kuadër të të cilit, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

- E. D., 33 vjeç, banues në Yrshek, Tiranë;
- E. B., 25 vjeç, banues në Yrshek, Tiranë;

Për shtetasit e lartpërmendur shërbimet e policisë të komisariatit Nr.6 dispononin informacion se lëviznin me sende të kundërligjshme me vete. Menjëherë nga shërbimet e policisë është organizuar operacioni policor "Aleati 2" për kapjen e tyre në flagrancë. Pasi shërbimet e policisë i kanë konstatuar këta dy shtetas në një lokal në zonën e Yrshekut, u kanë ushtruar kontroll fizik. Gjatë kontrollit fizik shtetasit E. D., iu gjet një armë zjarri pistoletë me krehër me fishekë, ndërsa shtetasit E. B., iu gjet një armë e ftohtë thikë dhe një sasi lënde e dyshuar kanabis.

U sekuestruan në cilësinë e provës materiale: një armë zjarri pistoletë me krehër me fishekë, një armë e ftohtë thikë dhe një sasi lënde e dyshuar kanabis.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme, për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit" në ngarkim të shtetasit E. D. dhe për veprat penale "Mbajtja pa leje e armëve të ftohta" e "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" në ngarkim të shtetasit E. B.